



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.111/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesuese, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit në shtylla të ndriçimit elektrik të kandidatit për anëtar të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dhe subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 750.00 (shtatëqindpesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 02.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 01.10.2017 në rrugën Isa Kastrati në Matiqan të Prishtinës në shtyllë të ndriçimit elektrik është vendosur poster i kandidatit për kuvend komunal nga subjekti politik AAK. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së 4.1 pika b) i Rregulles Zgjedhore të KQZZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 i Rregulles 13/2014.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 03.10.2017, subjekti politik AAK, thekson se shkeljet nuk janë bërë nga strukturat e AAK-së dhe se këto mun te jene bere nga qytetaret apo individ te pa identifikuar, andaj ne përgjigje ne ankesë theksohet se AAK me te pranuar ankesën ka ndermar veprimet e nevojshme duke e larguar posterin nga vendi ku ka qene i vendosur ai. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografimin me të cilat shihet se është larguar poster i reklamues nga vendi ku kanë qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posterit reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në shtylla të ndriçimit të energjis elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në objekte apo në rrugë publike.*”

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkëlur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterit reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik AAK, është vendosur në objekt publik dhe në rrugë publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik AAK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thot se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posterit reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik AAK është vendosur në objekt dhe në hapsirë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë i dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërrmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL. Anr.111/2017 më datën 03.10.2017.



Kryesuese e Panelit
Hasan Shala

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*